

IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë-Suharekë

Nr. Protokolli:336-2025..... Datë:25.03.2025.....

Në bazë të Nenit 11 të Udhëzimit Administrativ, - Aktivitetet jashtëshkollore Nr. 02/2016, 12.01.2016, IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë -Suharekë bën:

FTESË PËR OFERTË NR. 01/2025

Pas vendimit të marrë nga KDSH, u bëjmë thirrje Agjencive turistike të marrin pjesë për Ofertë për Projektin Shkollor "Ekskursioni i maturantëve, 2025" të IAAP "Abdyl Ramaj" Suharekë.

- Ekskursioni planifikohet të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë ndërmjet datave **28.04.2025** dhe **02.05.2025**. Kohëzgjatja e ekskursionit është **4** bujtje/5 ditë, me pansion të plotë;
- Numri i përgjithshëm i nxënësve maturant është **170** nxënës të ndarë në 10 klasë;
- Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit (mëngjesi+dreka+darka), transporti dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe ambiente tjera kulturo historike të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i Shkollës.

Operatorët Ekonomik që marrin pjesë në ftesën për ofertë të IAAP "Abdyl Ramaj" Shirokë, Suharekë për Projektin shkollor "Ekskursioni i maturantëve Prill/2025" duhet të i plotësojnë këto parakushte:

1. Licenca për transporti të organizuar të udhëtimeve jashtë shteti; Kopje e dokumenteve e noterizuara
2. Dëshmi të kontrollit teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore, fotokopje të dokumentacionit për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion. Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit dhe kapacitete të zëvendësimit të autobusëve në rast nevojë për kohë optimale;
4. Licenca "D" për drejtuesit e autobusëve, Fotokopje e noterizuar;
5. Certifikata e mjekut -CPC për shëndetin fizik dhe mendor të drejtuesve të autobusëve dhe përcjellësve të angazhuar në ekskursion;
6. OE të sigurojë përkujdesje mjekësore, për pjesëmarrësit në ekskursion gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Të ofrohet leja e punës së mjekut, marrëveshje kontraktuale me mjekun (fotokopje);
7. OE të ofrojë dëshmi për rezervimin e hapësirave hoteliere në Durrës, si dhe licencën e akreditimit të ushqimeve dhe ambienteve tjera rekreative për vendqëndrimin e nxënësve.
8. Hoteli ku bëhet akomodimit i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik profesional;
9. Dokumentet jashtë afatit të paraparë për ofertë nuk pranohen;
10. Dokumentet jo të kompletuara nuk shqyrtohen;
11. Afati i konkurrimit **7 ditë pune** nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
12. Formulari i paraqitjes së Ofertës dhe Itinerari i ekskursionit merret në IAAP "Abdyl Ramaj" në Shirokë prej datës:**26.03.2025**....., gjatë ditëve të punës.
13. Dorëzimi i ofertave bëhet deri më datë**03.04.2025**..... në ora **14:00** në zyrën pritëse të Komunës, Adresuar për: DKA-në në Suharekë, përEkskursioni i IAAP "Abdyl Ramaj" Suharekë;

Hapja e ofertave bëhet me datë**04.04.2025**..... në ora **15:00** në Sallën e Bordit të drejtorëve në Suharekë.

Suharekë, më **25.03.2025**

V.V. Drejtori i shkollës: Destan Berisha

